

# RELACION

## PËR PROJEKTVENDIMIN

### MBI

## ETIKETIMIN E USHQIMIT DHE INFORMIMIN E KONSUMATORIT

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i parimeve të përgjithshme në lidhje me praktikat e padrejta tregtare biznes – konsumator, duke përcaktuar aspekte të caktuara të sigurimit të informacionit për konsumatorët, e në mënyrë specifike, për të parandaluar veprimet mashtruese dhe mosveprimin e informimit të konsumatorit rreth sigurisë ushqimore si dhe vendosja e rregullave mbi mënyrën e etiketimit të produkteve ushqimore.

Për këtë qëllim, ky projektvendim, ka për objektiv të sigurojë bazën për garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit në lidhje me informacionin për ushqimin, duke marrë parasysh dallimet në perceptimin e konsumatorëve dhe informacionet e nevojshme për ta, dhe në të njëjtën kohë siguron funksionimin e duhur të tregut.

### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit është një nga prioritetet kryesore në programin politik të qeverisë shqiptare. Nëpërmjet miratimit të këtij projektvendimi krijohet mundësia për të përcaktuar parimet e përgjithshme, kërkesat dhe përgjegjësitë që rregullojnë informacionin e ushqimit në përgjithësi, dhe etiketimin e ushqimit në veçanti. Ajo përcakton mjetet për të garantuar të drejtën e konsumatorëve në informim dhe procedurat për sigurimin e formacionit të ushqimit.

Ky projektvendim është parashikuar në Programin Analitik të Akteve që do të miratohen për vitin 2017 në PKIE, kapitulli 12 “Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Fitosanitetit”, si dhe Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 – 2020.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Lëvizja e lirë e ushqimeve të sigurta dhe të shëndetshme është një aspekt thelbësor i tregut të brendshëm dhe kontribuon ndjeshëm në shëndetin, mirëqenien dhe në interesat ekonomike dhe sociale të konsumatorëve. Për arritjen e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve dhe për garantimin e të drejtës së tyre të informimit, duhet të garantohet

informimi i duhur i konsumatorëve në lidhje me ushqimin që ata konsumojnë. Zgjedhjet e konsumatorëve mund të ndikohen, ndër të tjera, nga pikëpamjet shëndetësore, ekonomike, mjedisore, sociale dhe etike. Një nga parimet e përgjithshme është të sigurojë një bazë për konsumatorët që të bëjnë zgjedhje të informuara në lidhje me ushqimin që konsumojnë dhe për të parandaluar çdo praktikë që mund të çorientojë konsumatorin.

Ky projektvendim mbulon aspekte të caktuara të dhënies së informacionit për konsumatorët, veçanërisht për të ndaluar veprimet çorientuese dhe mungesën e informacionit. Parimet e përgjithshme të praktikave të padrejta tregtare duhet të plotësohen me rregulla specifike për dhënien e informacionit ushqimor për konsumatorët.

Sipas rregullave për përmbajtjen dhe paraqitjen e informacionit për vlerat ushqyese në produkte ushqimore të ambalazuara paraprakisht. shtimi i informacionit për vlerat ushqyese është vullnetar, përveç nëse bëhet një deklaratë për vlerat ushqyese të produktit ushqimor. Shumica e dispozitave të përcaktuara deri tani datojnë janë vjetëruar dhe prandaj duhen përditësuar.

Riorganizimi dhe përditësimi është i nevojshëm në mënyrë që të garantohet përputhshmëri dhe qartësi më e madhe për palët e interesuara dhe për marrjen në konsideratë të zhvillimeve të reja në fushën e informacionit për produktet ushqimore. Kjo projekt VKM do t'u shërbejë interesave të tregut të brendshëm duke thjeshtësuar ligjin, duke garantuar siguri juridike dhe duke ulur barrën administrative, si dhe interesave të qytetarëve duke kërkuar etiketim të qartë, të kuptueshëm dhe të lexueshëm të produkteve ushqimore.

Fuqizimi i konsumatorëve, përmirësimi i mirëqenies së tyre, mbrojtja efektive e tyre është thelbësore si për konkurrencën efektive dhe mirëqenien e konsumatorit. Njohja e parimeve bazë për vlerat ushqyese dhe e informacionit përkatës të tyre për produktet ushqimore do të kontribuonte ndjeshëm në bërjen e zgjedhjeve të informuara nga konsumatori.

Është e nevojshme të përcaktohen përkufizime, parime, kërkesa dhe procedura të përbashkëta në mënyrë që të krijohet një kuadër i qartë dhe një bazë e përbashkët për masat e BE-së dhe kombëtare që rregullojnë informacionin ushqimor.

Gjithashtu për të ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse dhe zhvilluese për informacionin që u ofrohet konsumatorëve mbi ushqimin që konsumojnë, duhet të jepet një përkufizim më i gjerë i legjislacionit për informacionin ushqimor që mbulon rregulla të natyrës së përgjithshme dhe specifike, si dhe një përkufizim më i gjerë i informacionit ushqimor që mbulon edhe informacionin e ofruar nga elemente të tjera përveç etiketës.

Arsyeja kryesore për kërkimin e informacionit ushqimor të detyrueshëm, duhet të jetë, krijimi i mundësisë për konsumatorët për të identifikuar dhe përdorur siç duhet produktin ushqimor dhe për bërjen e zgjedhjeve që u përshtaten nevojave individuale dietike.

Ky projektvendim për informacionin ushqimor ndalon përdorimin e informacionit që mund të jetë çorientues për konsumatorin, veçanërisht sa i përket karakteristikave të ushqimit, efekteve

dhe vetive të tij apo vetive që u atribuon vlera kurative ushqimeve. Në mënyrë që ndalimi të jetë efikas, ai duhet të zbatohet gjithashtu edhe për reklamimin dhe paraqitjen e ushqimeve.

Etiketat ushqimore duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme, në mënyrë që t'i ndihmojnë konsumatorët që dëshirojnë të bëjnë zgjedhje më të mirinformuara dietike dhe për ushqimin.

Gjithashtu ky projektvendim është plotësimi i rekomandimit të Raport Progresit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 36, pika 3 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektvendim përafron në mënyrë të pjesshme Rregulloren nr. 1169/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2011, "Për dhënien e informacionit ushqimor për konsumatorët, që ndryshon rregulloret (KE) nr. 1924/2006 dhe (KE) nr. 1925/2006 të parlamentit evropian dhe të këshillit dhe që shfuqizon direktivën e komisionit 87/250/KEE, direktivën e këshillit 90/496/KEE, direktivën e komisionit 1999/10/KE, direktivën 2000/13/KE të parlamentit evropian dhe të këshillit, direktivat e komisionit 2002/67/KE dhe 2008/5/KE dhe rregulloren e komisionit (KE) nr. 608/2004.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është ndarë në 6 krerë dhe 15 shtojca.

Në **Kreun e parë** të tij, projektvendimi përcakton Qëllimin dhe Fushën e veprimit si dhe plotëson termat e përkufizuar në Nenin 3 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar, me përkufizimin e termave specifike të përdorura në këtë projektakt.

**Kreu i dytë** i projektvendimit përcakton parimet e përgjithshme për informacionin ushqimor duke dhënë objektiva të përgjithshme dhe parimet që rregullojnë informacion ushqimor të detyrueshëm.

Në **Kreun e tretë** jepen kërkesat e përgjithshme për informacionin ushqimor dhe përgjegjësitë e operatorëve të biznesit ushqimor, praktikat e informacionit të drejtë.

**Kreu i katërt** ku jepet informacioni i detyrueshëm ushqimor është i ndarë në 3 seksione.

**Në seksionin e parë** jepet përmbajtja dhe paraqitja e veçorive të detyrueshme, lista e veçorive të detyrueshme, veçoritë shtesë të detyrueshme për lloje dhe kategori specifike të produkteve ushqimore, disponueshmëria dhe vendosja e informacionit ushqimor të detyrueshëm, peshat dhe masat, shitja në distancë, kërkesat për gjuhën si dhe përjashtimi i disa veçorive të detyrueshme.

**Në seksionin e dytë** bëhet paraqitja e detajuar për veçoritë e detyrueshme, emri i produktit ushqimor, lista e përbërësve, përjashtimi nga lista e përbërësve, përjashtimi i përbërësve të produktit ushqimor nga lista e përbërësve, etiketimi i substancave ose i produkteve të caktuara që shkaktojnë alergji ose intolerancë, deklarimi sasior i përbërësve, sasia neto, data e jetëgjatësisë minimale, "të përdoret përpara" datës dhe data e ngrirjes, kushtet e ruajtjes dhe të përdorimit, shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes, udhëzimet e përdorimit dhe fortësiatë alkooolike.

Në seksionin e tretë jepen deklaratat e vlerave ushqimore, përmbajtja dhe llogaritja e vlerave ushqimore, shprehja për 100 g ose për 100 ml, shprehja për racion ose për njësi konsumi, paraqitja dhe format shtesë të shprehjes dhe paraqitjes.

**Kreu i pestë** jep kërkesat e zbatueshme për informacionin ushqimor vullnetar, mënyrën e paraqitjes në etiketë, kërkesat për qumështin dhe produktet e qumështit, pijet alkooolike, mënyrën e shprehjes së sasisë neto, paraqitjen e veçorive specifike për produktet ushqimore që nuk janë të paraambalazuara.

**Kreu i gjashtë** përmban dispozita kalimtare dhe të fundit ku jepet periudha tranzitore e hyrjes në fuqi për stoqet, shfuqizime dhe shtrirja e efekteve zbatuese.

Në shtojcën I jepen përkufizime specifike, shtojca II përmban substancat ose produktet që shkaktojnë alergji ose intoleranca, shtojca III jep produktet ushqimore për të cilat etiketimi duhet të përfshijë një ose më shumë veçori shtesë, shtojca IV tregon përkufizimin e lartësisë – x, shtojca V jep produktet ushqimore të cilat përjashtohen nga kërkesa e deklaratës së detyrueshme të vlerave ushqimore, shtojca VI jep emrin e produktit ushqimor dhe veçoritë specifike shoqëruese dhe është e ndarë në:

- pjesa "a" - veçoritë e detyrueshme shoqëruese të emrit të produktit ushqimor
- pjesa "b" - kërkesat specifike lidhur me emërtimin "mish i grirë"
  - kriteret e përbërjes të kontrolluara në bazë të një mesatare ditore
- pjesa "c" - kërkesat specifike lidhur me emërtimin e lëkurës së sallamit

Shtojca VII përmban deklarin dhe emërtimin e përbërësve dhe është e ndarë në:

- pjesa "a" - dispozitat specifike lidhur me deklarin dhe emërtimin e përbërësve në rend zbritës të peshës
- pjesa "b" - emërtimi i përbërësve të caktuar me emrin e kategorisë përveç emrit specifik
- pjesa "c" - emërtimi i përbërësve të caktuar me emrin e kategorisë së tyre të ndjekur nga emri specifik ose numri i tyre "e"
- pjesa "d" - emërtimi i aromatizuesve në listën e përbërësve

- pjesa "e" - emërtimi i përbërësve të përbërë

Shtojca VIII përmban treguesit sasiorë të përbërësve, shtojca IX deklarin e sasisë neto, shtojca X jep datën e jetëgjatësisë minimale, data "të përdoret para" dhe data e ngrirjes, shtojca XI përmban llojet e mishit për të cilët deklarimi i vendit të origjinës ose të prejardhjes është i detyrueshëm, shtojca XII jep tolerancat e lejueshme pozitive dhe negative në lidhje me deklarin e fortësisë alkoolike sipas vëllimit dhe të shprehur në vlera absolute.

Shtojca XIII ku jepen sasi të referuese:

- pjesa a - sasi referuese ditore për vitaminat dhe mineralet (tek të rriturit);
- pjesa "b" - sasi referuese për energjinë dhe vlerat e përzgjedhura ushqyese përveç vitaminave dhe mineraleve (tek të rriturit).

Shtojca XIV përmban faktorët e konvertimit për llogaritjen e energjisë;

Në shtojcën XV jepen shprehja dhe paraqitja e deklaratës së vlerave ushqyese.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim është përgatitur nga Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licecave dhe Monitorimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për tu dërguar për mendim në ministrinë e linjës dhe më pas për tu dërguar për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Zbatimi i këtij projektvendimi nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**NIKO PELESHI**

